

## Plani Social Bashkia Finiq

Plani i Shërbimeve Sociale për Bashkinë Finiq angazhon të identifikojë dhe të jap zgjidhje nevojave dhe të drejtat e grupeve vulnerable në gamën e shërbimeve sociale, fuqizimin e strukturave përgjegjëse vendore, përmirësimin e shërbimeve si dhe angazhimin e grupeve të interesit në vendimmarrje.

Plani është hartuar përmes një procesi konsultimi me përfaqësues të strukturave përgjegjëse vendore dhe grupeve të interesit për të garantuar një vlerësim sa më afër nevojave reale të grupeve e komuniteteve të ndryshme dhe mundësive për të identifikuar e adresuar këto nevoja ku ato janë prezente.

Reforma e re administrative-territoriale ka sjellë një sërë ndryshimesh në kompetencat e njësive të qeverisjes vendore si në shtrirje ashtu edhe në krijimin dhe administrimin e shërbimeve në nivel vendor. Në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” në nenin 24 përcaktohet se “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, të cilat fokusohen veçanërisht në krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale lokale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, etj Pra shërbimet e kujdesit shoqëror janë pjesë e e veprimtarisë funksionale të pushtetit vendor.

Njësitë e qeverisjes vendore kanë përgjegjësinë për të identifikuar dhe buxhetuar shërbimet e përkujdesit social, në bazë njësie, bazuar në vlerësimin e nevojave, identifikimin e burimeve financiare dhe partneriteteve vendore.

Plani i shërbimeve sociale është bazuar në qasjen e ofrimit të një pakete shërbimesh për të gjitha kategoritë e grupeve në nevojë si dhe në filozofinë e ndërtimit të partneritetit midis aktorëve të ndryshëm, si institucionet e qeverisjes vendore, rajonale dhe ato qëndrore, organizatat ndërkombëtare, kombëtare dhe ato lokale, si dhe biznesin vendor si një mbështetës potencial në fuqizimin e shërbimeve sociale.

Plani i shërbimeve sociale në Bashkinë Finiq shoqërohet gjithashtu me Planin e Veprimit (2019-2020) i cili është i ndarë në pesë fusha kryesore : (1) Strukturat dhe burimet njerzore ; (2) Shërbimet Sociale në Bashkinë e Finiqit ; (3) Zbutja e varfërisë; (4) Programet parandaluese; (5) Koordinimi dhe rrjetëzimi i shërbimeve dhe përcakton qëllimet dhe objektivat specifike, aktivitetet e parashikuara në terma kohorë, përgjegjësitë institucionale dhe burimet për realizimin e tyre.

Në këtë kuadër, Bashkia Finiq harton Planin Social të prezantuar në këtë dokument. Ky proces është mbështetur nga UNICEF si pjesë e programit të përbashkët të Qeverisë Shqiptare me Agjensitë e OKB-së, Leave No One Behind financuar nga SDC. dhe Europartners Development për të paraqitur atë në Këshillin Bashkiak për aprovim. Ky dokument është fokusuar në identifikimin dhe vlerësimin e nevojave, buxhetimin e tyre dhe identifikimin e burimeve financiare për zbatim duke rritur kapacitete vendore si horizontalisht e vertikalisht në këtë drejtim.

## PARIMET E PLANIT SOCIAL

Plani Social i Bashkisë Finiq (2019-2022) është në linjën e parimeve të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale (2015-2020) të cilat rrjedhin nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, Konventa për të Drejtën e Personave me Aftësi të Kufizuara, Karta Sociale Evropiane e rishikuar, Karta Evropiane e Autonomisë Lokale, Komunikata e Komisionit Evropian datë 12 Mars 1997 “Mbi modernizimin dhe përmirësimin e Mbrojtjes Shoqërore”, Strategjinë Evropiane deri në 2020.

E drejta për mbrojtjen sociale është reflektuar në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 9 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore njeh të drejtën e secilit individ për të pasur mbrojtje sociale. Në mënyrë të ngjashme, në Konventat e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijëve dhe mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara njohin gjithashtu të drejtat e veçanta për mbrojtjen sociale. Parimet janë:

***Të drejtat civile, barazia dhe mosdiskriminimi:*** Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, mosha, aftësitë e kufizuara, etj.

***Mbrojtja:*** Grupe të veçanta, duke përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.

***E drejta e jetës, mbijetesës dhe zhvillimit:*** Një mjedis i përshtatshëm duhet të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.

***Pavarësia, autonomia dhe respektimi i pikëpamjeve:*** Individët janë përgjegjës për jetën e tyre. Ata duhet të inkurajohen që të marrin vendime për jetën e tyre brenda normave që shoqëria ka vendosur.

***Përfshirja dhe integrimi.***

***Respektimi i të drejtave dhe nevojave.***

***Partneriteti:*** Koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.

***Cilësia e shërbimeve.***

***Standardet Kombëtare udhëheqin vendimmarrjen në nivel vendor.***

Referuar sërish Strategjisë së Mbrojtjes Sociale plani social është i bazuar në politikat e mëposhtme:

**A. Zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë,** duke mundësuar mbulimin më të mirë të familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër, përmirësimin e shënjestrimin e tyre, rritjen e transparencës dhe shmangien e abuzivitetit në skemën e Ndihmës Ekonomike si dhe lidhjen me shërbime të integruara e skemat e punësimit, me qëllim riintegrimin social të tyre.

**B. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara,** nëpërmjet vlerësimit bio-psiko-social bazuar në standardet ndërkombëtare të klasifikimit të aftësisë së kufizuar, duke

ndërthurur skemën e pagesave në Cash me shërbime të integruara, me qëllim integrimin në jetën shoqërore dhe ekonomike.

*C. Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit social*, bazuar në parimet e decentralizimit dhe deinstitutionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e Mbrojtjes Sociale, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri.

### **Reformat në sistemin e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror**

Qeveria shqiptare e mbështetur nga UNICEF që prej vitit 2012 ka ndërmarrë një sërë reformash në kudër të një reformimi të thellë të sistemit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë. Tani ne kemi një panorama të ndryshuar thellësisht si nga ana administrative dhe ajo ligjore, përgjegjësi dhe kapaciteteve për tu ballafaquar me këtë realitet të ri. Mbrojtja Sociale fokusohet tek individit dhe ka si objektiv “Zhvillimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror të decentralizuar, në mënyrë që grupet vulnerable të përfshihen në programet e mbrojtjes sociale duke inkurajuar pjesëmarrjen e plotë dhe efektive të këtyre grupeve në jetën active. Në këtë pikëpamje, sistemi shërbimeve të kujdesit shoqëror, lozin një rol të rëndësishëm në përmirësimin e pozicionimit të statusit shoqëror, të jetesës së individit dhe familjes së tij si dhe harmonizohet jeta në komunitet. Vizioni ynë për këto shërbime është ngritja e një sistemi të mirëkoordinuar për kujdesi shoqëror e social, që të jetë i kudo ndodhur, i qëndrueshëm dhe i vashdushëm në nivel vendor duke u mbështetur në strategjitë dhe politikat në nivel qendror, i cili do të krijojë ambiente të sigurta buxhetimi e kapacitetesh.

Objektivat ambicioze që ne si Bashkia Finiq kemi, mbështeten në Ligjin Nr. 139/2015 për “Vetqeverisjen vendore”, i cili u jep kompetenca njësi të qeverisjes vendore dhe në fushën e përkuajtjes shëndetsor dhe social si organe që janë më në kontakt me komunitetet vulnerabël brenda territorit të cilat ato mbulojnë.

Vizioni i sipër përmëndur mbështete në Ligjin Nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” që jep përgjegjësi dhe kompetenca të gjitha grupeve të interesit të përfshirë që nga krijimi i strukturave përkatëse dhe kompletimin e tyre në nivel vendor duke krijuar garanci në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe social.

Ligjet, VKM-të dhe urdhëresat përcaktojnë të drejta dhe detyrime specifike për shërbimet e kujdesit shoqëror në nivel vendor, që konsiston në ngritjen e strukturave më të specifikuar për realizimin e tyre si Njësia e Referimit dhe Vlerësimit të Nevojave, Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Njësit e Dhunës në Familje, të cilat ngelen një sfidë për Bashkinë Finiq.

Shërbimet e kujdesit shoqëror janë për përfituesit e tyre dhe u takon atyre, atje ku ata janë, për fëmijët, gratë, të moshuarit e personat me aftësi të kufizuar dhe se Bashkitë kanë detyrimin ligjor të ofrojnë shërbime shoqërore e sociale dhe për ta konkretizuar në Mars të vitit 2017 u nënshkrua Pakti Social midis gjithë Kryetarëve të Bashkive të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare. Ky Pakt angazhon fortë palët në zbatimin e Ligjit të Shërbimit të Kujdesit Shoqëror, ai është një kontratë pune në përmbushje të të drejtave e detyrimeve të Qeverisë dhe

Bashkive si dhe tregon seriozitetin dhe vullnetin e Bashkive për të mbështetur grupet në nevojë pa hezituar dhe me cilësi sipas kërkesave të ligjeve në fuqi.

Viti 2018 shënon vitin e parë që Shërbimet e Kujdesit Shoqëror u jepet mundësia tu aksesohen grupeve vulnerable, në nivel Bashkie, përmes krijimit të një strukture si ajo e mbrojtjes së fëmijëve, të referimit dhe vlerësimit të nevojave, të grave të dhunuara si dhe ajo e strehimit. Viti 2019 është viti i parë që krijohet nga Qeveria dhe Bashkitë, Fondi Social si dhe planifikimi i Shërbimeve të Kujdesit Social sipas shportës së shërbimeve në nivel lokal, pra sipas planifikimit të bërë nga Bashkia Finiq. Një nga prioritetet e Bashkisë Finiq do të jetë aftësia e tërheqjes së fondeve nga Fondi Social, nga financimet dhe donacionet vendase dhe të huaja. Në zbatim të kësaj, ambicja jonë është plotësimi pa vonesë i një arkitekture strukturore në nivel bashkie siç kërkohet nga ligji dhe Pakti Social. VKM-të, udhëzimet dhe urdhëresat që janë miratuar e priten të miratohen, krijojnë instrumente të rinj financiare si dhe buxhetimin në nivel lokal për vitin 2019. Bashkia Finiq duhet të përmbush detyrimet ligjore dhe të realizojë ambicjet e saj për të ofruar dhe garantuar mbrojtje dhe përmirësim të jetës së qytetarëve të saj, që i përkasin grupeve vulnerable, në frymën e re të ligjit për shërbimet e kujdesit shoqëror.

### **Situata e mbrojtjes shoqërore në Bashkinë Finiq**

Duke marrë në konsiderat reformën territoriale, përbërjen shoqërore dhe sociale si dhe kapacitetet e Bashkisë Finiq parashtrihen disa sfida dhe prioritete në gamën e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë bashki:

Në Bashkinë Finiq ekziston një staf shumë i kufizuar në Sektorin e Mbrojtjes Sociale dhe Ndhmës Ekonomike e cila krijon një mbingarkesë, po ashtu stafi i Njësive Administrative është minimal dhe administrimi i dokumentacionit dhe i pagesave të Ndhmës Ekonomike e Të Paaftësisë zënë pjesën dermuase të kohës së punë në krahasim me shërbimet e kujdesit shoqëror apo të identifikimit dhe referimit të rastit. U ngrit Njësia e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave, e cila me gjithse modeste nga përbërja, do të referoj nevojat nëpër mjet referimeve direkte nga grupe apo individë në nevojë, por dhe vlerësimin e tyre sipas kërkesave të ligjit dhe zbatimit të vendimeve dhe urdhëresave për këtë fushë aplikimi. Ka vështërsi në administrimin e pagesa pasi infrastruktura është e kufizuar duke përmendur mungasën e Degëve të Filialeve të Bankave, Zyrat e Postës janë vetëm në Qëndrat e Njësive Administrative. Informimi i qytetarëve has vështërsi edhe se sistemi i adresave është gati inegzistent, por dhe telefonia në shumë hapësira të territorit të Bashkisë Finiq është i pambuluar me sinjal telefonik. I vetmi informim që respektohet është ai i shpalljes në këndin e informimit të bashkisë për afatet e komisionimit dhe te informimit të fituesit.

Në këto kushte është e nevojshme jo vetëm rritja e statusit të sektorit në Zyrë apo Drejtori por dhe plotësimin e strukturës me punonjës social të trajnuar ose të specializuar sipas kërkesave të ligjit si dhe implementimin e këtyre kërkesave në Rregulloren e Funkcionimit të Bashkisë. Ndërkohë mungon një presencë e konsoliduar e OJF-ve që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror për të gjitha grupet në nevojë.

### *Ngarkesa e punës së administratorit shoqëror dhe paafësia*

Nr.	Grupet në nevojë sipas njësi administrative	Finiq	Aliko	Dhivër	Livadhja	Mesopot	Totali
1.	<i>Numri i personave me P.A.K.</i>	41	28	51	62	41	223
2.	<i>Invalid pune</i>	62	61	93	135	61	412
3.	<i>Familje me Ndhimë ekonomike</i>	7	0	16	25	5	53
4.	<i>Numri i personave</i>	23	0	52	76	12	163
5.	<i>Numri i administratorëve shoqëror</i>	1	1	1	1	1	5
6.	<i>Numri i fëmijëve</i>						
7.	<i>Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve aktualisht</i>	0	0	0	0	0	0
	<i>Numri i punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve sipas ligjit</i>	0	0	0	0	0	0
8.	<i>Popullsia</i>						
9.	<i>Numri i punonjësve social aktualisht</i>	0	2	0	0	0	2
10.	<i>Numri i punonjësve social sipas ligjit</i>						

Me ngritjen e Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave dalin në pah dhe faza të tjera si ajo e burimeve të buxhetimit, të infrastrukturës së pagesave dhe të kujdesit të ofrimit të shërbimit. Mungesa e një stafi të patrajnuar dhe të specializuar, mundësitë e pakta që ofron vet Bashkia, territory i gjërë i mbulimit si dhe infrastruktura rrugore e dobët, ku në disa fshatra ajo mungon e bënë të vështirë ndjekjen e rasteve që kanë nevojë për vizita në shtëpi sipas ligjit, shërbimet e kujdesit shoqëror në shtëpi si dhe ballafaqimin koherent me rastin.

Ndryshimi i pozicionit, në strukturën organizative të Bashkisë, të mbrojtjes sociale dhe ndihmës ekonomike, kërkon domosdoshmërinë e hartimit të rregullores së funksionimit të pozicionit duke përshkruar në mënyrë sa më të plotë punën që do të kryej stafi i pozicionit në përputhje me ligjshmërinë e fushës dhe ngarkesës së punës. Vetëm kështu do të rritet përgjegjësia në punë, do të mire përdoren të drejtat dhe detyrimet, rritet llogaridhënia dhe mundësit e matjes së performancës. Bashkia synon të angazhojë, rakordojë dhe të kërkojë mbështetjen e gjithë aktorëve të fushës për trajnime, seminare e forma të tjera bashkëpunimi të cilat rrisin kapacitetet programuese, zbatuese dhe monitoruese të strukturës së mbrojtjes sociale dhe ndihmës ekonomike.

### **Prioritetet e mbrojtjes shoqërore në Bashkinë Finiq**

Shërbimet e kujdesit shoqëror të ofruara deri më tani në Bashkinë Finiq kanë qënë me shtrirje dhe kapacitete të limituara për t'iu përgjigjur larmishmërisë dhe thellësisë së nevojave të komunitetit, duke mbuluar vetëm një pjesë të nevojave me të domosdoshme elementare të grupeve vulnerable. E tashmja dhe e ardhmja na përballin me kërkesa në rritje si në shtrirje dhe në thellësi të nevojave të kujdesit shoqëror por dhe atyre të rejave, të cilat të marra sëbashku bëhen më komplekse dhe duhet një angazhim serioz dhe i përgjegjshëm për të garantuar ofrim sa më të mire të shërbimeve sociale por dhe një qëndrueshmëri të tyre. Prioritetet në drejtim të Shërbimeve të kujdesit shoqëror përfshijnë :


- Plotësimi i strukturës së Bashkisë Finiq me emërtesa dhe personel që të garantojë ofrimin e shërbimeve shoqërore në bazë të normave të shërbimit për njësi të popullatës për të përballuar detyrat e drejtimit, menazhimit, administrimit dhe planifikimit të nevojave të shërbimit të kujdesit shoqëror në gjithë gamën e tyre.

- Plotësimi me infrastrukturën e nevojshme që duhet për realizimin e angazhimeve në këtë drejtim.
- Ndërtimi i një qendre multifunksionale, e cila të ofrojë shërbime sa më të larmishe për të gjitha kategorit vulnerable të identifikuar në territorin e Bashkisë Finiq si për fëmijë dhe për të rritur duke përfshirë dhe institucione parandaluese.
- Ofrimi i shërbimit 24 orësh për grupet e fëmijëve në nevojë, nënave të dhunuara dhe ngritjen e qendrës së emergjencave ( 72 orësh ) për pritje emergjente të rasteve.
- Ngritja e shërbimeve një ditore për të moshuarit në çdo qender Njësie Administrative.
- Ndërtimi i programeve parandaluese për njohje, edukimin dhe ndërgjegjësim të problematikave të identifikura të grupeve vulnerable, të të pastrehëve, grave të trafikuar, të dhunës në familje, të rinj të riskuar për abuzime me substance narkotike etje.

### Prioritetet me OJF-të

OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve shoqërore në gjithë territorin e Shqipërisë. Bashkia Finiq ka një prezence minimale dhe të brishtë të pranisë së OJF-ve. Miratimi dhe zbatimi i këtij Plani Social, përveç se përmbush kërkesat e Ligjit për Shërbimet Shoqërore është dhe një platformë bashkëpunimi mbi të cilën të ndërtohen marrëdhëniet me OJF-të, donatorët dhe palët e treat të interesuara. Konstituimi i Grupit të Dialogut Social në Bashkinë Finiq është hap i pare i garantimit të një bashkëpunimi të grupeve të interes.

### Harta digitale e shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Finiq



## **Plani i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Finiq 2019 – 2022**

### **Misioni**

Bashkia Finiq synon të konsolidojë Sektorin e Mbrojtjes Sociale dhe Ndhimës Ekonomike dhe të ofrojë më shumë shërbime të standartizuara dhe cilësore të kujdesit shoqëror, për të mbuluar nevojat sociale në rritje të grupeve vulnerable dhe komunitetit. Ky mision synon të arrijë objektivat përmes realizimit sa më të mirë të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, identifikimit dhe vënja në efikasë të shërbimeve të reja dhe gjendja sa më pranë dhe kohë reale pranë qytetarëve sipas skemave dhe praktikave më të mira në këtë fushë.

### **Vizioni**

Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Finiq do të jenë gjithëpërfshirëse, të shtrira në gjithë territorin, të shumëllojshme dhe të bazuar në nevoja reale për shërbime sociale ndaj popullsisë. Ato do të ofrohen në përputhje me kërkesat e ligjit të shërbimeve shoqërore duke krijuar standare sa më të mira shërbimi, duke u bazuar tek personi, shumëllojshmëria dhe menaxhimit të rastit të mbështetur nga një infrastrukture racionale dhe efikase. Bashkia Finiq do të konsolidojë gamën e shërbimeve shoqërore ekzistuese, systemin gjithëpërfshirës duke synuar mbulim sa më të plotë të tyre të cilat kanë në fokus gjithë aktorët. Sistemi i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Finiq do të ketë në dispozicion burimet njërezore, material dhe financiare të nevojshme për të siguruar shërbime të cilat grupet vulnerable dhe komuniteti ka nevojë për rritjen e standarteve të jetës dhe mirëqënies.

### **Plani i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror kërkesat ligjore, por dhe detyrim ndaj shtesave në nevojë**

Plani i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Finiq ( 2019 – 2022 ) është një dokument politikash specifike për shtesa e grupe të identifikuar në territorin e Bashkisë në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale ( 2015 – 2020 ), Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim ( 2015 – 2020 ) dhe detyrimeve e përgjegjësive që burojnë nga kërkesat e ligjit për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, me Paktin Social të firmosur nga Kryetarët e Bashkive të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues të Qeverisë si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave që sigurojmë mbështetje dhe garanci në zbatimin e legjislacionit të fushës. Ky plan do të jetë pjesë e planeve vjetore të Bashkisë duke siguruar e garantuar zbatimin e tij si në shtrirje dhe në thellësi nëpërmjet koordinimit me strukturat e tjera vendim marrëse. Kjo siguron disponimin e fondeve perkatëse si dhe alokimin e tyre racionale.

Plani Social synon të krijoj struktura institucionale dhe mekanizma të domosdoshëm administrativ në shërbim të grupeve vulnerable, të identifikojë kostot dhe burimet financiare për mbulimin e tyre në mënyrë që shërbimet e kujdesit shoqëror të ofrohen për familjet dhe grupet në nevojë sipas projektit të hartuar duke pasqyruar realitetin, por që do monitorohet e përditësohet vazhdimisht.

Mbështetja sociale, për grupet në nevojë, në Bashkinë Finiq përveç respektimit të kërkesave ligjore, konsiston dhe në respektimin social të tyre duke komunikuar drejt dhe sqaruar me durim dhe këmbëngulje të drejtat dhe detyrimet ligjore që duhet të kenë parasysh.

Monitorimi në vijueshmëri i zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të jetë objekt i diskutimit të strukturave drejtuese në Bashki, të Këshillit Bashkiak dhe partnerëve tanë duke treguar matshmërinë dhe transparencën e tij.

Spektori i Mbrojtjes Sociale dhe Ndhmës Ekonomike është përgjegjës për hartimin dhe përditësimin e një hartëzimi të plotë të shërbimeve në territorin e Bashkisë duke përfshirë dhe ato që janë potenciale. Spektori i Mbrojtjes Sociale dhe Ndhmës Ekonomike instrumentin e hartizimit të shërbimeve e shikon si mundësi të implementimit të shërbimeve të reja, të mbështetjes së tyre me burime njëzore efikase, të përpjekjes së sigurimit të burimeve financiale të mbulimit duke ruajtur qëndrueshmëri në ofrimin e shërbimeve.

### **Situata e Shërbimeve të Kujdesit Shoqërorë në Bashkinë Finiq**

Bashkia Finiq regjstron një pullsi prej rreth 34315 mijë banorë dhe aktualisht nuk e plotëson kërkesën ligjore të ngarkesës për 4 punonjës social ( 1 punonjës për 10 000 banor ). Ajo përbëhet nga 5 Njësi Administrative , - Finiq, - Mesopotam, - Aliko, - Dhivër dhe Livadhja të shtrira në një sipërfaqe prej 433 km<sup>2</sup>. Në Bashkinë Finiq, shërbimet e kujdesit shoqërorë rezultojnë të shpëndara pak a shumë në mënyrë uniforme në Njësitë Administrative por këto shërbime janë të limituara.

Shërbimeve të Kujdesit Shoqërorë që ofrohen në Bashkinë Finiq janë të natyrës jorezidenciale për asnjë prej grupeve në nevojë, siç janë fëmijët, grate e dhunuara, të moshuarit etje, por janë të natyrës së mbështetjes me shërbim kur lind nevoja për to.

Përveç shërbimeve të mbështetura nga Bashkia operojnë dhe institucione jo publike që mbështesin dhe ofrojnë avokati për mbrojtjen e grave të dhunuara, këshillim dhe pronovim të barazisë sociale dhe gjinore si dhe rritjen e rolit të gruas në shoqëri. Në Njësitë Administrative shërbimet sociale janë shumë të kufizuara ku ne Njësitë Mesopotam, Aliko dhe Dhivër ato mungojnë .

Burimet njëzore të pakta, infrastruktura rrugore jo e mirë, mungesa e aseteve dhe terreni i gjere i mbulimit bëjnë që cilësia e shërbimeve të ofruara të ketë nevojë për përmirësime. Pasqyra e kësaj situatë ka nevojë të ndryshojë që të sigurohet njëherësh zbatimi i detyrimeve ligjore dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror cilësor duke u dhënë njëzore që kanë nevojë për keto shërbime atë më të mirën.

### **Rruga që duhet ndjekur për t'i garantuar shërbimet e kujdesit shoqëror qytetarëve të Bashkisë Finiq**

Reforma e ndërmarrë në fushën e Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror, ndryshimet ligjore dhe Ligji i Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror i mbështetur dhe me VKM-të në zbatim të tij, kanë rritur e ngarkuar derjtpëdrejt Bashkinë me përgjegjësinë e adresimit real të nevojave për shërbime të të gjithë grupeve në nevojë. Këto ndryshime ligjore sjellin dhe një qasje të re filozofike dhe një



modelim të tërë skemës së ofrimit të shërbimeve nga ai aktual i ndihmës ekonomike, drejt një qasje të ofrimit të shërbimeve direkt tek individit dhe familja, e cila arrihet përmes skemës së menaxhimit të rastit dhe punës ndërsektoriale si brenda Bashkisë ashtu dhe Bashki – Njësi Administrative, duke rakorduar gjithë burimet e brendshme dhe të jashtme me pjesëmarrjen e grupeve të interesit.

Si hap i parë për zbatimin e ligjshmërisë dhe të përmbushjes së vulnetit të Bashkisë për sigurimin e ofrimit të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror në Bashkinë Finiq mbetet plotësimi i strukturës me staf të trajnuar dhe profesional. Plotësimi me punonjës social dhe logjistik duhet bërë për të garantuar mbulimin dhe menaxhimin sa më efektiv të rasteve në të gjithë territorin e Bashkisë, koordinim më të mirë të raportit Bashki – Njësi Administrative apo dhe në nivel institucional rajonal si me ISSH-në, arsimin, policinë etjera. Në përputhe me angazimet dhe me mundësit e burimet, të rritet niveli strukturor i shërbimeve nga Sektor në Drejtori.

Punë e mirë duhet të bëhet në drejtim të trajnimit të stafit në Bashki si dhe të Njësisve Administrative për njohjen e objektivave të qeverisë si dhe rakordimin e tyre me objektivat e Bashkisë, përmirësimin e vashdueshmë të rregulleve dhe procedurave përmes të cilave realizohet programimi, menaxhimi dhe ofrimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Finiq. Kjo do ta bënte më të lehtë punën e Sektorit të Mbrojtjes Sociale dhe Ndihmës Ekonomike, por do të krijonte ambjent për një koordinim të të gjithë aktorëve, duke garantuar shërbim të adresuar, në kohë dhe cilësi, për qytetarët e Bashkisë Finiq në përgjithësi por dhe atyre të ekspozuar për shërbime të kujdesit shoqëror.

Bazuar në strukturën e popullatës, në vlerësimin e nevojave për shërbime në territorin e Bashkinë Finiq përmes punës së përditshme të stafit të bashkisë, ofruesve të shërbimeve, institucioneve jashtë bashkisë, shportës bazë të shërbimeve si dhe prioritetet e qeverisë janë hartuar prioritetet e Bashkisë Finiq si zhvillimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe atyre të reja të paraqitura më poshtë. Këto prioritete janë reflektuar edhe në planin e veprimit 2019 – 2022. Ky plan veprimi është ndërtuar në dy shtylla kryesore, atë të zhvillimit, përmirësimit të shërbimeve ekzistuese dhe atë të krijimit dhe zhvillimit të shërbimeve të reja.

### **Prioriteti e zhvillimit të shërbimit të kujdesit shoqëror në Bashkisë Finiq**

Bazuar në një analizë dhe vlerësim të situatës së deritanishme të nevojave për shërbime në territorin e Bashkisë Finiq nga konsultimet dhe diskutimet e vazhdueshme me stafin e saj, partnerëve dhe grupet e interesit janë përcaktuar prioritetet e mëposhtme për zhvillimin e ofrimit të shërbimeve ekzistuese dhe atyre të reja të shërbimeve të kujdesit shoqëror për vitin 2019 – 2022 të pasqyruara në planin e veprimit.

#### **Zhvillimi i shërbimeve ekzistuese:**

- Fuqizimi i strukturave të Bashkisë me staf me nivel profesional punonjës social dhe psiko – social, riorganizimi dhe ristrukturimi i Sektorit të Mbrojtjes sociale dhe ndihmës ekonomike në nivel drejtorie, e cila do të merret me gjithë gamën e shërbimeve në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

- Plotësimi me rregullore të punë së Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Rastit brenda kuadrit të rreguores së funksionimit të Sektorit ( Drejtorisë ) të Mbrojtjes Sociale dhe Ndhmës Ekonomike.
- Mbulimi më i mire në terren të rasteve që trajtohen, përfshi dhe vizitat në familje.
- Përmirësimi i punës, ngritja e nivelit kulturor të përfaqes ndaj rasteve që do të trajtohen dhe atyre që do të bëjnë kërkesa në evidentimin dhe krijimin e databazës në fushën e kujdesit shoqëror.
- Përmirësimi i punës në drejtim të njohjes së grupeve vulnerable me të drejtat dhe detyrimet që ua nje ligji mbi kujdesin shoqëror.

### **Zhvillimi i shërbimeve të reja:**

- Ngritja e një Qendre Multi-funksionale me infrastrukture të përshtatshme dhe personel ku të ofrohen shërbime integrale për të gjithë qytetarë dhe grupet vulnerable, si për fëmijë dhe për të rritur.
- Ofrimin e shërbimeve dhe strehimin e pëkohshëm (24 orësh/72 orësh) të rasteve në situatë emergjence si:
  - Fëmijë të rrugës.
  - Viktima të dhunës në familje.
  - Emigrantë apo azilkërkues
- Ngritja e një qendre të trajtimit me terapi fizike, psikiko – sociale të personave me aftësi të kufizuar, të personave që marrin lëndë narkotike, të personave të alkoolizuar etj.

Plani Social i Bashkisë Finiq synon të sigurojë garantimin e mbrojtjes dhe përmirësimit të jetës së qytetarëve, por dhe një jetë me dinjitet të të gjithë atyre që përfitojnë shërbime të kujdesit shoqëror.

## **Objektivat strategjike të Planit Social 2019 – 2022**

### **Ojetivi strategjik 1. - Vlerësimi, fuqizimi, riorganizimi dhe pasurimi i shërbimeve sociale.**

Kjo do të arrihet përmes konsolidimit të Sektorit të Mbrojtjes Sociale dhe Ndhmës Ekonomike duke riorganizuar organogramën e Bashkisë Finiq si dhe plotësimi me personelin e duhur sipas nevojave dhe kërkesave ligjore si strukturimin dhe mirëfunksionimin e Njesisës Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit. Sektorit të Mbrojtjes Sociale dhe Ndhmës Ekonomike do të përditësojë hartën e shërbimeve ekzistueset e kujdesit shoqëror duke vlerësuar dhe analizuar përmirësimin e saj. Do të arrihet përdorim sa më optimal i burimeve që disponon bashkia për të patur një transparencë në përdorimin e Fondit Social. Për të shtuar gamën e shërbimeve që ofrohen në territorin e bashkisë synohet ngritja e një Qendre Multi-funksionale, e strehëzës së emergjencave si dhe ngritja e një qendre trajtimi psiko – fizik dhe psiko – social.

### **Ojetivi strategjik 2. – Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë.**

Përkrahja dhe mbështetja e familjeve në nevojë do të kryhet nëpërmjet identifikimit të familjeve aplikante të cilat nuk përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike apo nuk marrin pikët e duhura, aprovimit të kriterëve të cilat të përfaqshijnë numër sa më të madhë familje në nevojë, vendosje e një rregullore sa më profesionale për përfitimin e fondeve si atë prej 6% dhe ato të bashkisë për të

siguruar një vendimmarrje sa më afër realitetit dhe fondet të mirëpërdoren. Riaftësim profesional për integrimin në tregun e punës sidomos për viktimat e dhunës në familje, nenat kryefamiljare, fëmijët e rrugës etj.

**Ojektivi strategjik 3. – Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuar.**

Ngritja e një qendre rehabilitimi nëpërmjet trajtimit me terapi të specializuara për aftësimin e personave me aftësi të kufizuar të të gjitha grupeve deri dhe të shërbimet në shtëpi për persona që kanë nevojë për to. Në funksion të kësaj do të mundësojmë specialist të fushës të cilë të angazhohen në ofrimin e shërbimeve specifike trajtimi dhe aftësimi. Do të krijojmë modele të ndryshme për të gjetur skemën e përshtatëshme trajtim – aftësimit me kuarime minimale dhe më pas zbatimin e modelit.

**Ojektivi strategjik 4. – Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre.**

Për të garantuar mbrojtjen e fëmijëve dhe potencialit të tyre synohet fuqizimi i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të administratorëve social në çdo njësi të Bashkisë duke kryer ngritjen e kapaciteteve të administratorëve social, mirëpërcaktimin e detyrave dhe përgjegjësive të tyre përmes përshkrimit të punës dhe ndarjes së detyrave. Gjithashtu do garantohet ofrimi 24 orësh në përgjigje ndaj nevojave emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje përmes ngritjes dhe funksionimit të vazhdueshëm të Strehëzës së Emergjencave pritëse për rastet që evidentohen ( 2 shtretër 24/7) si dhe ngritja e Qendres Multifunksionale ku veç të tjera do funksionojë dhe seksioni i fëmijëve me pjesën e mbrojtjes, të fuqizimit të familjes së tyre, njohjes së të drejtave dhe detyrimeve si dhe të aftësimit. Do të kryhen aktivitete informuese dhe ndërgjegjësimi për mbrojtjen e fëmijëve si dhe rritja e kapaciteteve profesionale dhe logjistike të Sektorit të Mbrojtjes Sociale dhe Ndihmës Ekonomike për identifikimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve.

**Ojektivi strategjik 5. – Kualifikimi i stafit dhe përmirësimi i planifikimit, vendimmarrjes në fushën e shërbimeve shoqërore përmes mbështetjes në evidenca.**

Përmes trajnimeve synohet të rriten kapacitete e stafit për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbi funksionimin e NJVRR, zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social, funksionimin e shërbimit të Strehëzës së Emergjencës, funksionimin e Qendrës Multi-funksionale etj. Gjithashtu synohet krijimi i kultures së mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave sociale në mënyrë të qëndrueshme, ngritja e sistemit të regjistrimit të aplikantëve/nevojave me të dhëna sa më agregate dhe ngritja e kapaciteteve të stafit mbi mbledhjen e të dhënave, plotësimin e evidencave, përpunimin dhe përdorimin e tyre përmes trajnimeve në funksion të planifikimit dhe vendimmarrjes.

## **Strategjia e zbatimit të Planit Social**

### **Zbatimi**

Zbatimi i Planit Social është detyrë e Drejtorisë së Shërbimit Social. Për zbatimin e Planit kjo strukturë kërkon dhe siguron bashkëpunim dhe koordinim të punëve me të gjithë aktorët institucional në nivel vendor dhe kombëtarë, publikë dhe jo publikë.

## **Raportimi**

Raportimi mbi zbatimin e Planit Social do të realizohet në bazë të raporteve periodike 6 mujore dhe vjetore të monitorimit dhe vlerësimit nga SMSNE në bashkëpunim me GDS.

## **Monitorimi dhe vlerësimi**

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të sigurojë që Plani Social i Bashkisë Finiq po zbatohet sipas afateve dhe objektivave të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara me ato që po zbatohen në terren.

Monitorimi është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit drejt arritjes së objektivave strategjik dhe specifik të këtij Plani Social. Ai siguron mbledhjen sistematike të të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij plani për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Monitorimi është pjesë kyçe e menaxhimit të mirë dhe llogaridhënies. Monitorimi konsiston në atë që zbatuesit dhe aktorët përgjegjës për këtë plan sigurohen që puna për realizimin e objektivave janë në përputhje me ato të planifikuara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara. Parashikon marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime si dhe bënë të mundur evidentimin dhe parashikim e vështërsive. Monitorimi kryhet në interval kohore mujore, tremujore, gjashtëmujore e vjetore, i cili kërkon informacion nga :

- *Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit ku futen staf, financat, logjistika dhe koha.*
- *Proceset, aktivitetet ku përdoren burimet njërzore dhe financiare për të arritur pritshmërit si dhe lloji dhe numri i këtyre aktiviteteve.*
- *Outputet (produktet/shërbimet), rezultatet që përfitohen përmes realizimit të aktiviteteve.*

Monitorimi i zbatimit të Planit Social të Bashkisë Finiq do të kryhet nga Grupi I Dialogut Social në bashkëpunim me SMSNE. Afatet kohore të monitorimit do të vendosen nga njësi përgjegjëse në varësi kohëzgjatjes së çdo aktiviteti përgjatë vitit kalendarik.

Vlerësimi është një analizë e detajuar e arritjeve që synon rishikimin e planit përkundrejt pritjeve të planifikuara dhe të përdorë eksperiencën e fituar për të përmirësuar punën në të ardhmen si në planifikim dhe në realizim. Vlerësimi fokusohet në rezultatet duke marrë në konsideratë burimet, rezultatet në lidhje me kostot, rrugët për arritjen e rezultatit. Vlerësimi identifikon efektet dhe ndikimet e performances së planit të realizuar dhe rrugët për realizimin e tij.

## **Rreziqet për zbatimin e planit.**

Me gjithë përpjekjet për të hartuar një plan social bazuar në nevojat e identifikuarasi dhe motivimin e Bashkisë për ta bërë atë të zbatueshëm duhen marrë parasysh dhe disa rreziqe që mund të hasen gjatë këtij procesi. Mosnjohja e ndryshimeve ligjore dhe përgjegjësive të kaluara bashkisë për sigurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror që u takojnë grupeve vulnerable përbënë një rrezik prezent që mund të ndikojë negativisht në zbatimin e planit social. Rrezik ngelen dhe kufizimet e burimeve financiare të bashkisë si dhe pamjaftueshmëria e burimeve njërzore në sasi dhe cilësi të SMSNE. Një rrezik tjetër për zbatimin e planit social mund të paraqites dhe ndryshimi i strukture organizative dhe përbërja e stafit të tyre.